



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

Nr. 01/ 30 /2011
Data: 02/03/2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, mbështetur në Statutin e Komunës, Ligjin për Financat Lokale, Rregulloren e Kuvendit të Komunës neni 15, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 24.02.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR

RRITJEN E BUXHETIT TË VITIT 2011 NGA TË HYRAT VETANAKE TË KOMUNËS PËR SHPËRNDARJEN E TYRE PËR SHPENZIME

I

Aprovohet rritja e të hyrave vetanake të Komunës të vitit 2010 dhe shpërndarja e tyre për shpenzime – Buxhetit shtesë i Komunës në shumë prej 67,431.13 €.

II

Duke i referuar pikës I të këtij vendimi buxheti shtesë si rezultat i tejkalimit të planifikimit të të hyrave vetanake të vitit 2010 shpërndahen në programin buxhetorë – zyra e Kryetarit kategoria ekonomike subvencione dhe transfere si dhe në programin buxhetor të urbanizmit në kategorinë ekonomike investime kapitale sipas tabelës nr. 1 që do t'i bashkëngjitet këtij vendimi.

III

Ekzekutimin e këtij vendimi do ta bën Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit.

V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Departamenti i Buxheteve Komunale,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi



**RRITJA E BUXHETIT 2010 NGA TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE
DHE SHPËRNDARJA E TYRE PËR SHPENZIME**

Për vitin 2010 planifikimi i të hyrave vetanake ka qenë 147,921 € , ndërsa gjatë këtij viti kemi realizuar gjithsej 215,352.13 €, pra kemi një rritje prej 67,431.13 € .

Tabela nr. 1. Rritja e buxhetit 2010 nga të hyrat vetanake 2010 dhe shpërndarja e tyre në kategorinë ekonomike Shpenzime kapitale

Kodi i depart.	Programi buxhetor	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale	Shuma
160/16035	Zyra e Kryetarit	11 256.23		11 256.23
660/66480	Planifikimi Urban		56 174.90	56 174.90
	Gjithsej	11 256.23	56 174.90	67 431.13

Tabela nr.1. Shpërndarja e rritjes së buxhetit nëpër projekte kapitale.

Kodi i Projektit	Emri i Projektit	Shuma
81426	Mjete të lira për bashkëinvestime	36 174.90
81430	Fond për shpronësim	20,000.00
	Gjithsej	56 174.90